



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.01/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga anëtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Faton Ademi, dhe Adnan Konushevcu anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lartë Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur lidhur me apelin e subjektit politik Lista Srpska, me seli në Komunën e Mitrovicës së Veriut, të paraqitur kundër, Vendimit me Nr.358/2019 të datës 24.04.2019, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të mos certifikimit të subjektit politik Lista Srpska, për pjesëmarrje në zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të komunave në Mitrovicën Verior, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok, që do të mbahen me datë 19.05.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 25.04.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET pjesërisht si i bazuar apeli i subjektit politik Lista Srpska, me seli në Komunën e Mitrovicës së Veriut.

II. ANULOHET vendimi i Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ), me Nr. 358/2019 i datës 24.04.2019, **URDHËROHET** Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ), ta certifikon subjektin politik Lista Srpska, me kandidatët për kryetar të Komunave: Goran Rakiq për Mitrovica e Veriut, Vuqina Jankovic për Zveçan, Srdjan Vulovic për Zubin Potok, dhe Zoran Todic për Leposaviq, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme që do të mbahen me datë 19.05.2019.

III. Refuzohet i pabazuar, apeli i subjektit politik Lista Srpska, në pjesën e apelit që ka të bëjë me njoftimin e Prokurorisë Kompetente, për ekzistimin e elementeve të veprës penale në raport me veprimet e anëtarëve të KQZ-së.

IV. Hudhet si i palejuar, apeli i subjektit politik Lista Srpska, me të cilën ka kërkuar, të vërtetoi se vendimi i KQZ-së, me Nr. 358/2019 i datës 24.04.2019, është në kundërshtim me nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe se me këtë vendim është shkelur e drejta pasive e votimit.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë me vendimin e atakuar Nr.358/2019 të datës 24.04.2019, në pikën 1 të dispozitivit ka vendosur që nuk miratohet rekomandimi i Zyrën për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim (ZRPPC) për certifikimin Partisë Politike Lista Srpska dhe kandidatëve të saj për kryetar të komunave: Leposaviq, Zubin Poto, Zveçan dhe Mitrovica e Veriut, për zgjedhjet e jashtëzakonshme të datës 19 Majit 2019. Në pikën 2 të dispozitivit, ka vendosur që të: Obligohet Zyra që ta njoftoj Partin Politike Lista Srpska për marrjen e këtij vendimi. Në pikën 3 të dispozitivit ka vendosur që: ky vendim hy në fuqi në momentin e shpalljes.

Kundër vendimit të atakuar përfaqësuesi i autorizuar i subjektit politik Lista Srpska në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur ankesë duke e goditur vendimin e atakuar: për shkak të shkeljeve të konsiderueshme të dispozitave të Ligjit Nr. 2008/03L-073 dhe Ligjit Nr. 03/L-256 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për zgjedhjet të përgjithshme dhe, për shkak të shkeljeve të konsiderueshme të dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-072 për zgjedhjet lokale dhe për shkak të shkeljeve të konsiderueshme të Kushtetutës, me propozim që PZAP-i, ta pranojë ankesën si të bazuar, të vërtetojë se me vendimin e KQZ-së, është shkelur e drejta pasive e votimit për subjektin politik Lista Srpska dhe për 4 kandidatët për kryetar të komunave: Zoran Todici për komunën e Leposaviqit, Srdjan Vulović për komunën e Zubin Potokut, Vuçina Janković për komunën e Zveçanit dhe Goran Rakić për komunën e Mitrovicës së Veriut. Të vërtetojë se vendimi i KQZ-së është në kundërshtim me nenin 45 të Kushtetutës dhe nenin 2 dhe 15 të LZP-së dhe neni 3, 13 dhe 14 të LZL. Të urdhërohet KQZ që të certifikoj subjektin politik dhe 4 kandidatët për kryetar të komunave: Zoran Tadić për komunën e Leposaviqit, Zlagjan Vulović për komunën e Zubin Potokut, Vuçina Janković për komunën e Zveçanit dhe Goran Rakić për komunën e Mitrovicës së Veriut dhe të njoftoj Prokurorinë kompetente se në veprimet e anëtarëve të KQZ-se, ekzistojnë elemente të veprimeve të ndaluara nga neni 35 i ligjit Nr. 2008/03L-073 për zgjedhjet e përgjithshme me dyshimin e bazuar se janë bërë vepra penale nga neni 210 dhe 214 i Kodit Penal të Kosovës 04/L-082.

Apeli, ju ka dorëzuar në afatin e paraparë ligjor KQZ-së, të njëjtit kanë paraqitur përgjigje në apel duke dhënë sqarime për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të vendimit të ankimuar, të përshkruar më dicidivisht si në parashtresën e datës 25.04.2019, të cilës ja kanë bashkangjitur, dhe atë: Rekomandimin e ZRPPC-së, Aplikacionin dhe komplet dosja për aplikim e Partisë politike Lista Srpska dhe kandidatëve të saj, Kërkesën për Certifikim të subjektit politik, Listën e kandidatëve, Formularin për certifikim të kandidatëve për secilin kandidat, Formularin e

publikimit financiar të kandidatit, Deklaratën politike, Logon dhe Vendimin e ankimuar te i KQZ-së Nr. 358/2019, te datës 24.04.2019.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP-i, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pas administrimit të pretendimeve ankimore, vendimit kontestues të datës 24.04.2019 me numër protokolli 358/2019 të KQZ-së dhe përgjigjes në apel të KQZ-ZRPPC-së gjeti se:

Apeli është pjesërisht i bazuar.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës rezulton se: subjekti politik Lista Srpska, me kandidatët për kryetar të Komunave ka aplikuar, në zgjedhjet e jashtëzakonshme lokale që do të mbahen me datë 19.05.2019, në ZRPPC - KQZ-ë.

Me rekomandimin nr. 271/22.04.2019, të ZRPPC-së, është rekomanduar para KQZ-së, se subjekti politik Lista Srpska, i ka plotësuar kushtet ligjore për tu certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje të jashtëzakonshme për Kryetar të katër (4) Komunave të Veriut të Kosovës që do të mbahen me datë 19.05.2019.

KQZ-ja, duke vendosur sipas rekomandimit nr. 271/22.04.2019, të ZRPPC-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 24.04.2019, nuk e ka miratuar rekomandimin e ZRPPC-së, duke vendosur si në dispozitiv të vendimit të atakuar.

Në arsyetim të vendimit të atakuar KQZ-ë, ka theksuar se në bazë të nenit 63 para. 4, dhe në mungesë të konsensusit për marrjen e vendimit për miratim të rekomandimit të zyrës, KQZ-ë ka hedhur në votim rekomandimin e zyrës për certifikimin e partisë Lista Srpska dhe kandidatë e saj për kryetar të komunave, Leposaviç, Zubin Potok, Zvečan dhe në Mitrovicën e Veriut, në të cilin votim 7 anëtarë të KQZ-së, kanë votuar pro dhe dy anëtarë kanë abstenuar, duke mos arritur 2/3 e votave për miratimin e rekomandimit të zyrës.

Paneli, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, qëndrimin dhe përfundimin e KQZ-së, të përshkruar si në pikën -I-, të dispozitivit të vendimit të atakuar, nuk mund ta pranoi si të drejt dhe të ligjshëm një qëndrim të tillë meqenëse se i njëjti është në kundërshtim me dispozitat ligjore që i referohen aplikimit dhe certifikimit të subjekteve politike, me konkretisht nenit 15 të LZP-së, i cili përcakton, Kushtet të cilat subjektet politike dhe individët si kandidat duhet të plotësojnë në mënyrë që të marrin pjesë në zgjedhje, ndërsa neni 15 paragraf 5 parasheh si ne vijim: 15 par. 5 *KQZ e certifikon subjektin politik me të drejtë pjesëmarrjeje nëse i njëjti e dorëzon aplikimin e plotësuar, në formën e përshkruar dhe në datën e vendosur nga rregullat e KQZ-së.*

Ndërsa neni 16 par. 1 i LZP-së parasheh se Zyra është e obliguar të kontrollojë secilin aplikacion për certifikim, dhe nëse konstaton se subjekti politik nuk ka plotësuar të gjitha kriteret të përcaktuara më nenin 15, atëherë e njëjta është e obliguar që dhjetë (10) ditë pas marrjes së aplikacionit, të dërgojë njoftimin subjektit politik lidhur me arsye apo arsyet përse aplikacioni nuk është adekuat.

Neni 16 par. 3 i LZP-së parasheh se ZRPPC-ja i bënë rekomandim me shkrim KQZ-së për apo kundër miratimit të secilit aplikim që pranon brenda pesë (5) ditëve nga pranimi i dokumentacionit të plotë. Rekomandimet përmbajnë shpjegim të shkruar për secilin kritë. Asnjë parti nuk certifikohet nëse nuk i plotëson kriteret e përcaktuara më tutje.

Ne rastin konkret Paneli vërtetoi se Lista Serbska, ka dorëzuar Aplikimet e kompletuara, ne përputhshmëri me afatin e përcaktuar nga KQZ-ja konform nenit 15 par. 5 i LZP-së, dhe KQZ-ja është e obliguar që të certifikoj çdo subjekt politik i cili i plotëson kushtet e parapara ligjore siç i ka plotësuar ne rastin konkret subjekti politik Lista Serbska.

Andaj Paneli vendosi si në pikat -I- dhe -II-, të dispozitivit të këtij vendimi konform neneve: 53 paragrafi 1, 131 paragrafi 4, 132 paragrafi 5, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative me Nr.05/L-031.

- Me nenin 53 par. 1 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet: *“Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj.*

- Me nenin 131 par. 4 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet: *Kur organi publik kompetent vlerëson se ankesa është e pranueshme dhe e bazuar plotësisht, me një akt të ri administrativ do të anulohet apo ndryshojë aktin e ankimuar, gjegjësisht do të lëshojë aktin e refuzuar, siç është kërkuar nga pala, dhe*

- Me nenin 132 par. 5 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet: *Nëse është e nevojshme, organi epror mund të urdhërojë organin kompetent që të formulojë aktin që do të nxirret nga organi epror, bazuar në udhëzimet e këtij të fundit.*

Paneli vlerëson se nga dispozitat e lart cituara ligjore, rezulton se vendimi i atakuar është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për çka vendosi si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi, dhe urdhëroi KQZ-në, që të zbatojë vendimin e PZAP-it konform dispozitës së nenit 118 paragrafi 5 të LZP-së.

Paneli me rastin e vendosjes si në pikën -III-, të dispozitivit të këtij vendimi, gjatë ekzaminimit të pretendimeve nga apeli, vlerëson se në rastin konkret nuk përmbushën elementet të veprës penale për të cilat pretendon pala apeluese, ndërsa detyrimi i PZAP-it për përcjelljen e rastit në zyrën e Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës, konform nenit 3.11 të Rregullës Nr. 02/2015 të PZAP-it, i referohet përgjegjësisë individuale, gjatë një procesi zgjedhore, por e cila nuk ka të bëjë me sanksionimin e procedurës së votimit .

Paneli vendosi si në pikën -IV-, të dispozitivit të këtij vendimi, për arsye se PZAP-it, i mungon kompetenca lëndore, për të vendosur, përkitazi me kërkesat e paraqitura në pikën -II- dhe -III-, të apelit, për arsye se për të vlerësuar pohimet në apel përkitazi me shkeljet e pretenduara të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, e jo në juridiksion të PZAP-it.

Në pajtim me nenin 115.1 lidhur me nenin 118.1 të LZP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 01/2019 më datën 25.04.2019



Kryesuesi i Panelit,

Gyltene Sylejmani

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit prej njëzet e katër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi në Gjykatën Supreme të Kosovës.*